



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:153931

Datë: 12.11.2020

Numri i dokumentit: 01266621

A.nr.1017/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarin Hajriz Hoti, e me zyrtar ligjor, Fatlum Gashi në konfliktin administrativ të paditëses, Sh. S. nga fshati H., Komuna e F., të cilin me autorizim e përfaqëson, M. S., djali i paditëses, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, e cila përfaqësohet nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimeve dhe njohjes së të drejtës në pension për personat me paaftësi të kufizuar të përhershme në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të palës së paditur, më datë;10.11.2020, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, Sh. S. nga fshati H., Komuna e F., anulohet vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, me nr.6016536 i dt.26.02.2018 dhe i dt.17.10.2017 dhe paditëses i njihet e drejta në kompensim në emër të se drejtës në pension për personat me paaftësi të kufizuar të përhershme dhe atë prej datës;11.10.2017 e deri me dt.11.10.2020.

II. Po ashtu paditëses i njihet e drejta në pension për persona me paaftësi të kufizuara të përhershme në kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe atë nga data;11.10.2020 e deri me dt.11.10.2026.

III. Detyrohet e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale, që paditëses në mënyrë retroaktive t'ia kompensoj pagesat për pensionin për persona me paaftësi të kufizuar të përhershme nga dt.11.10.2017 e deri me dt.11.10.2020 shumën prej 75 Euro, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit me detyrim.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prani të autorizuarit të paditëses, dhe në mungesë të palës së paditur të thirrur në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditëses, M. S. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës se saj duke theksuar se në bazë të raportit mjekësor sikurse edhe shumë raporte tjera ekipi i mjekeve në përbërje të Dr.D. B.-Neurolog, Dr.A. H.-Endokrinologe, dhe Dr.B. P.-Oftamologe, kanë konstatuar që znj.Sh. S. është person me paaftësi të përhershme për punë. Neurologu thekson qartë në raport se ka dëmtime të përhershme neurologjike 70% dhe pacientja nuk mund të ecë vet, endokrinologja po ashtu thekson se pacienti e ka paaftësi të përhershme për punë, ndërsa Oftamologia konstaton se aftësia e të pamurit të pacientes është zvogluar për 85% dhe pacientja nuk sheh. Të gjitha këto tregojnë qartë se e paditura me rastin e ndaljes së pensionit ka bërë shkelje të drejtave të paditëses. I ka propozuar Gjykatës që të anulohen vendimet e të paditurës si të kundërligjshme dhe paditëses t'ia njohë të drejtën në pension për personat me paaftësi të kufizuar të përhershme dhe atë nga data e ndërprerjes së këtij pensioni në rivlerësim.

E paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, përmes avokaturës shtetërore në përgjigjen e dhënë në padi të dt.30.04.2019, ka theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj i ka propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim me të cilën refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses duke lënë në fuqi vendimet e të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor dt.10.11.2020, ka bërë administrimin e provave dhe atë; vendimet e të paditurës të dt.26.02.2018, dt.17.10.2017, dt.18.10.2016, dhe dt.06.11.2017, ankesa e paditëses e dt.14.12.2017, fletëlëshimi i QKUK në Prishtinë me nr.598 i dt.25.04.2018, NR.731 i dt.29.03.2018, nr.1409 i dt.27.03.2018, nr.965 i dt.17.07.2017, dt.15.09.2014, nr.2607 i dt.03.08.2012, nr.1415 i dt.09.03.2019, dhe nr.133 i dt.28.02.2019, vlerësimi i Komisionit mjekësor i të paditurës i dt.16.10.2015, dt.14.10.2016, dt.11.10.2017, dhe dt.24.01.2018, raporti i Qendrës Diagnostike "E." në Prishtinë i dt.17.10.2017, raport konziliar i lëshuar nga QKUK në Prishtinë i dt.16.05.2019, si dhe ekspertiza e përgatitur nga mjek specialist të QKUK-së në Prishtinë e dt.12.10.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve të goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenin 46.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar.

Nga vendimet e kontestuara del se ato përmbajnë të meta të tilla, për shkak të të cilave, nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i të paditurës i dt.26.02.2018, është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk është dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit kontestues është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Këshilli i ankesave si organ i shkallës së dytë me ekspert mjekësor të lëmisë përkatëse duke vepruar sipas ankesës të Z/Nj Sh. S. në seancën e dt.24.01.2018, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 për PAK ka konstatuar se ankuesja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme mjekësore për të qenë shfrytëzuese e pensionit me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme andaj Këshilli i ankesave pajtohet me vlerësimin e komisionit të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret për PAK dhe konform kësaj ankesën e refuzon si të pa bazë”.

Me vendimin e të paditurës të dt.06.11.2015, Gjykata vëren se, paditëses i është njohur e drejta në pensionin për persona me paaftësi të kufizuara, në shumë prej 40 euro për muaj, për periudhën kohore për 1 (një) viti.

Po ashtu edhe me vendimin e të paditurës të dt.18.10.2016, Gjykata vëren se, paditëses i është vazhduar e drejta në pensionin për persona me paaftësi të kufizuara, për periudhën kohore për 1 (një) viti.

Ndërsa me vendimin e të paditurës të dt.17.10.2017, paditëses i është refuzuar kjo e drejtë me arsyetim se aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston pas rivlerësimit.

Kjo gjykatë pas administrimit të provave si me lart pasi i ka vlerësuar një nga një provat e sipërcituara, i fali besimin raporteve mjekësore të paditëses, vendimit të paditurës të dt.06.11.2015 dhe dt.18.10.2016, me të cilin paditëses i është njohur kjo e drejtë në pensionin për persona me paaftësi të kufizuar, për periudhën kohore prej dy viteve, e në veçanti ekspertizës të nxjerrë, nga Gjykata për paditësen me dt.12.10.2020, në përbërje prej tre (3) specialistëve të fushave përkatëse të QKUK-së, Dr.D. B.-Neurolog, Dr.A. H.-Endokrinologe, dhe Dr.B. P.-Oftamologe, të caktuar për këtë ekspertizë, të cilët pasi kanë ekzaminuar paditësen drejtpërdrejtë kanë nxjerrë përfundim, “grupi i eksperteve konstaton se pacientja Sh.S., ka këto semundje: Dg.St. post ICV ischemica; Diabetes mellitus typ II; Hypertensio arterialis; CMP chr. Hypertensiva; Status post ablatio retinae et hematovitreus; Retinopathia diabetica; Nephropathia diabetica; Pseudophakia; Pterygium int; polyneuropathia sensorimotorica diabetica. Grupi i eksperteve konkludon se në bazë të raporteve mjekësore në shkresat e lëndës, ekzaminimit klinik të pacientes kemi arritur në përfundim se pacientja është me paaftësi të përhershme për punë”.

Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar si provë dhe vlerësimin Komisionit Mjekësor të paditurës, për faktin se pikërisht këto Komisione Mjekësore, ia kanë njohur këtë lloj të pensionit për periudhën kohore prej 2 viteve ankueses, duke theksuar se është person me paaftësi të kufizuara të përhershme, dhe pastaj i ndërprejnë këtë të drejtë me rastin e rivlerësimit me dt.11.10.2017, se më nuk e ka këtë paaftësi. Ndërsa, nga shkresat e lëndës vërtetohet se gjendja e saj shëndetësore nuk ka ndryshuar dhe këtë fakt e vërtetoj edhe ekspertiza e QKUK-së, e nxjerrë në procedurë gjyqësore. Nga të gjitha këto arsye kjo Gjykatë nuk mundi të falë besimin mendimit dhe konstatimit të Komisionit Mjekësor të paditurës si provë e vetme e që vërteton se paaftësia e përhershme e kufizuar tek paditësja nuk ekziston dhe atë pas dy viteve pasi që i është njohur e kjo e drejtë paditëses. Nga faktet e vërtetuara më lart Gjykata i ka njohur këtë të drejtë paditëses për periudhën kohore nga ndërprerja e pensionit në rivlerësim ashtu që të

njëjtës ti bëhet edhe kompensimi në mënyrë retroaktive pasi që baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar me anulimin e vendimeve të kontestuara.

Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vërtetoi se Sh.S. është person me paaftësi të kufizuar të përhershme dhe të njëjtës ia njehë të drejtën e kërkuar në pajtim të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenit 9, paragrafet 1 dhe 5 të të njëjtit, ku përcaktohet se “Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh; Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nënparagrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.”

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi të dt.30.04.2019, mirëpo të njëjtat i vlerëson si të pa bazuara, nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është vërtetuar se paditësja i plotëson kërkesat e ligjit të sipërcituara, për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të nenit. 2, 5 lidhur me nenet 5, 6, 38, 43. 3, dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 9 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.1017/2018, dt.10.11.2020

Zyrtar Ligjor
Fatlum Gashi

G j y q t a r i
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita te marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:153931
Datë: 12.11.2020
Numri i dokumentit: 01266621